

RAPORT I DETAJUAR I TRAJNIMIT

Titulli: Vëzhgimi dhe dokumentimi në fëmijërinë e hershme

Data: 9 dhjetor 2023

Vendi: Qendra Mediale

Trajnere: Prof. Violeta Buza

Qëllimi i trajnimit:

Ky trajnim kishte për qëllim të pajisë pjesëmarrësit me njohuri teorike dhe praktike mbi rëndësinë, teknikat dhe përdorimin profesional të vëzhgimit dhe dokumentimit në institucionet e edukimit të hershëm. Qëllimi kryesor ishte të theksohej roli i tyre në ndjekjen e zhvillimit të fëmijës, vlerësimin formativ dhe planifikimin e personalizuar të mësimdhënies.

Përmbajtja e trajnimit:

1. Vëzhgimi si bazë për të nxënëit e personalizuar:

- U prezantuan mënyrat e vëzhgimit aktiv të fëmijës në mjedisin e përditshëm.
- U diskutua rëndësia e neutralitetit dhe objektivitetit në procesin e vëzhgimit.

2. Llojet e vëzhgimit:

- Vëzhgim informal, sistematik, incident kritik dhe analiza e sjelljes.
- Përzgjedhja e teknikës në varësi të qëllimit të vëzhgimit.

3. Dokumentimi i të dhënave të mbledhura:

- U shpjeguan mënyrat për shënimin e të dhënave përmes fletëve të strukturuar, ditarëve të fëmijës, fotografive, skicave dhe materialeve audiovizive.
- U theksua rëndësia e dokumentimit për të pasqyruar progresin dhe zhvillimin individual të fëmijës.

4. Zhvillimi i instrumenteve për vëzhgim dhe dokumentim:

- Pjesëmarrësit punuan në grupe për të ndërtuar instrumente vëzhgimi të thjeshta dhe funksionale.

- U ofruan shembuj konkretë për moshat 3-6 vjeç.

5. Përdorimi i dokumentimit në planifikim dhe komunikim me familjen:

- U prezantuan mënyrat për ta përfshirë dokumentimin në raportimin ndaj prindërve dhe në hartimin e planeve të personalizuara edukative.
- U theksua se dokumentimi i mirë është urë ndërmjet edukatorit, fëmijës dhe familjes.

Metodologjia e trajnimit:

Trajnimi u zhvillua në formë interaktive, me kombinim të prezantimeve teorike, punës në grupe, rasteve studimore dhe diskutimeve reflektuese.

U krijua hapësirë për ndarjen e përvojave konkrete nga pjesëmarrësit dhe për aplikimin praktik të koncepteve të trajtuara.

Rezultatet dhe përfitimet:

- Pjesëmarrësit treguan angazhim dhe interesim të lartë për temën.
- Ata u njohën me qasjet bashkëkohore të vëzhgimit dhe dokumentimit në edukimin e hershëm.
- Trajnimi ndihmoi në përvetësimin e aftësive për përdorim praktik të të dhënave të vëzhgimit për vlerësim, planifikim dhe komunikim me prindërit.
- U nxit reflektimi profesional mbi rëndësinë e dokumentimit të përditshëm si pjesë integrale e punës edukative.